



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME GJIROKASTËR SH.A

NJËSIA E PROKURIMIT

Nr _____Prot

Datë / /2024

PROCESVERBAL – Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburanti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

” Blerje karburanti

Kodi 09100000-0 karburante

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKGJ sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Shenim: Operatori ekonomik fitues paraprakisht ,sebashku me dokumentacionin e dorëzuar ne sistemin elektronik,duhet te paraqesi edhe dokumentacion e vetdeklaruar ne Formularin 8 ,origjinal ose te noteriazuar.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne nenin 76,82 dhe 83 te LPP ,neni 24 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

-Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 20% e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 gërma b), të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **po pa tejkalluar vleren maksimale të përcaktuar në këtë procedure**, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuar

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 40, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje tregtimi me pakicë të lëndëve djegëse Licencë për stacionin e shitjes se karburanteve ,per tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm naftës për automjete,vajrave lubrifikant dhe te njesive te lendeve djegese per perdorim nga konsumator fundor sipas Ligjir nt. 8450 date 24.02.1999 dhe Vendimit te Keshillit t eMinistrave nr.970 date 02.12.2015 “Per përcaktimin e

procedurave dhe te kushteve per dhenien e licensave per tregtimin e naftes bruto dhe nenprodukteve te saj(i ndryshuar)

- **Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,
- Operatori ekonomik duhet te kete minimumi 1(nje) stacion te tregtimit me pakice te karburanteve brenda territorit te Qarkut te Gjirokastrës te vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (akt pronësie ose kontrate noteriale qeraje ose te kete kontrate furnizimi(bashkepunimi) ose te jene te pasqyruara ne Ekstraktin e regjistrit tregtar leshuar nga QKB.

Stacionet e tregtimit te karburantit detyrimisht duhet te jene te pajisur me vertetim teknik leshua nga ISHTI ose organet e miratuara te vleresimit te konformitetit (OMVK)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion infrastrukturën e nevojshme fizike dhe teknike për realizimin e kontratës që konsiston në disponimin e stacioneve të tregëtimit të karburantit dukeqënë objekti i kontratës është furnizimi me karburant i automejeteve të AK gjatë lëvizjes së tyre në territor.

Ky kriter është vendosur duke ju referuar natyrës dhe objektit te veprimtarisë së AKBN e cila referuar VKM nr. 547 datë 9.8.2006 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, konsiston në zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik. Në këtë kuadër specialistët e AKBN janë në detyra inspektimi dhe monitorimi në terren mbi të gjitha burimet natyrore (hidrocentrale, miniera, vendburime naftë) ku ato kanë vendodhjen dhe si rrjedhojë automjetet e AKBN që transportojnë specialist kanë të nevojshëm disponueshmërinë për tu furnizuar me karburant në pika të ndryshme gjatë itinerarit që përshkojnë që të minimizojnë kostot. Është përcaktuar që stacionet e tregtimit të karburantit të jenë minimalisht nga 1 pikë për cdo qark të Republikës së Shqipërisë sepse esdhe vendodhjet e burimeve natyrore që inspektohen nga AKBN janë të përqëndruara në të gjithë qarqet e vendit, kjo e konfirmuar edhe nga drejtoritë teknike të AKBN me shkresat nr. 2294/4 prot., date 25.06.2021 të Drejtorisë Minerare, nr. 2294/6 prot., datë 13.07.2021 të Drejtorisë së Monitorimit të Hidrocentraleve, nr. 2294/3 prot., date 17.06.2021 të Drejtorisë Hidrokarbure.

- OE duhet te paraqese Certificate te mbrojtjes nga zjarri nga MZSH dhe police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperik ,per distributoret ne shitje me pakice te cilt duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise ne ditën e hapjes se ofertave.

- OE duhet te paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI qe subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise per vitin 2023.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nënt 40, pika 6, gërma c,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, VKM nr. 410, datë 13.5.2015 ”Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, VKM nr. 147 datë 21.3.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, Benzinë dhe Diezel”.

- Subjekti duhet te paraqese dhe deklaratat si me poshte:
 - a) Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor ose tollona sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
 - b) Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike
 - c) Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku duhet te kryejne furnizimin e sasise se karburantit nepermjet kartave elektronike te personalizuara per cdo automjet te Autoritetit Kontraktor.
 - d) Operatori ekonomik ne baze te VKM nr.561 date 29.07.2016 ”Per standarizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme ” operatoret ekonomike pjesmarres xduhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (ëebpage) ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike te personalizuar me targen e mjetit.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet te ofroje sherbimin e ngarkimit te sasise se karburantit nga OE drejt AK,me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targen e mjetit si dhe administrimi i sasiese se karburanteve te kryhet ne menyre te pavarur nga AK.
 Faqja e menaxhimit te karburanteve (ëebpage) duhet te ofroje informacion dhe raporte te ndryshme te levrimimit dhe qarkullimit te karburantit,te jete e pavarur dhe e kontrollueshme nga AK.
 Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet faqes se menaxhimit te karburanteve (ëebpage),qe ofron OE pjesmarres perben kusht per skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT

1-Arqile Puleri

2-Bexhet Baxhella

3-Suada Guma